



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-178949/23, më 30.08.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Vendimi për caktimin e organit mbikëqyrës për Kontratën në shtëpi "Kontratë për mirëmbajtjen e rregullt teknike dhe renovimin urgjent të ndërtesave edukativo-arsimore në Komunën e Prishtinës" e lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes Publike Banesore (NPB) me nr. 030/01-122176/23 e dt. 30 Qershor 2023.
2. Anëtarët e organit mbikëqyrës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 1. Arton Ajeti, menaxher, Drejtoria e Inspektionit;
 2. Arber Gashi, mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit, Drejtoria e Arsimit;
3. Detyrat dhe punët e organit mbikëqyrës të cekur në pikën 2 të këtij vendimi janë: Mbikëqyrja e kontratës dhe përpilimi i raporteve për gjendjen e konstatuar, masave dhe veprimeve që janë marrë sipas obligimeve të përcaktuara në kontratë.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, organi mbikëqyrës do t'i raportojë Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të organit mbikëqyrës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

